

**NJOFTIM PËR SHITJEN E PASURIVE TË PALUAJTSHME TË SHOQËRISË
"BELLE AIR" SH.P.K, SUBJEKT NË PROCEDURË FALIMENTIMI**

1. Belle Air sh.p.k
2. Pasuria objekt shitje është:
 - Pasuri e paluajtshme me nr. 237/4, Vol. 9, Fq. 55, Zonë Kadastrale nr. 3096, me sipërfaqe 18.480 m², e llojit Kullotë, ndodhur ne Qerekë, Krujë
3. Shitje nëpërmjet Ankandit të Hapur
4. Subjektet e interesuara mund të njihen me asetin në adresën përkatëse Qerekë , Krujë nga data 02.07.2024 deri në datë 11.07.2024 dhe me Raportin e Vlerësimit te publikuar në faqen e internetit www.albanianbis.com.
5. Ankandi do të zhvillohet në ambjentet e zyrës së administratores së falimentimit, në datë 11.07.2024 ora 11:00. Ftohen subjektet e interesuara të paraqesin ofertat me zarf të mbyllur në adresën e Administratores së Falimentimit, Rr. "Panorama", Pallati "Sara-El", Shk. 1, Ap. 1, Tiranë-Shqipëri.
6. Çmimi i shitjes është 554.400 Euro.
7. Depozita për pjesëmarrjen në shitjen e sendit të interesuar, është 20% e vlerës së pasurisë së paluajtshme dhe duhet depozituar para hapjes së ankandit në llogarinë nr. 401587830CLPRCFEURAS me nr IBAN AL4720511014587830CLPRCFEURA në në Bankën Kombëtare Tregtare (Tiranë-Albania). Mandati i depozitës duhet paraqitur ditën e zhvillimit të ankandit në zyrën e adminstratores së falimentimit në adresë. Rr. "Panorama", Pallati "Sara-El", Shk. 1, Ap. 1, Tiranë-Albania.
8. Depozituesi do të humbasë të drejtën e tij për rimbursimin e depozitimit nëse nuk arrin të:
 - a) Regjistrohet ne ankand
 - b) Paraqitet në ankand
 - c) Nënshkruajë në procesverbalin e ankandit
 - d) Nënshkruajë kontratën e shitjes si blerës i deklaruar
 - e) Paguajë çmimin e shitjes brenda afateve të përcaktuara si blerës i deklaruar
 - f) Nënshkruajë kontratën e shitjes brenda afateve të përcaktuara si ofertuesi i dytë me çmimin më të lartë, mbas tërheqjes së blerësit të deklaruar
 - e) Paguajë çmimin e shitjes brenda afateve të përcaktuara si ofertuesi i dytë me çmimin më të lartë, pas tërheqjes së blerësit të deklaruar
9. Oferta paraqitet në përputhje me pikën V, të standartit Nr 5, të "Standarteve Kombëtare për Administrimin e Masës së Falimentimit" miratuar me VKM Nr. 124 datë. 06.12.2013. Do te shpallet fitues, pjesëmarrësi ofertues qe ofron vlerën më të lartë në favor të autoritetit shitës për blerjen e objektit të shpallur për shitje.
10. Fituesi i ankandit është i detyruar të paguajë çmimin e shitjes jo më vonë se 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës së shitjes.
11. Rimbursimi i depozitave për pjesëmarrësit në ankand do të realizohet brenda 8 ditëve kalendarike nga data e zhvillimit të ankandit përveç blerësit të deklaruar dhe ofertuesit të dytë më të lartë.

Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës ne kopje fizike, me poste ose dorazi, ne vendin e përcaktuar ne dokumentet e ankandit. Për çdo informacion mund të kontaktohet në adresën e sipërshtënëuar të administratores së falimentit.

Shpresa Breçani,
Administratore Falimentimi
e shoqërisë "Belle Air" sh.p.k, shoqëri në falimentim

